



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 530 Prot.

Tiranë, më 13.07.2017

V E N D I M

Nr. 159, datë 13/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 59, datë 17.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Këshillin e Qarkut Korçë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 59, datë 17.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Këshillin e Qarkut Korçë",

VËREJ SE:

Bazuar në Vendimin Nr.21, dt. 11.03.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Korçë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr.59, datë 17.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Këshillin e Qarkut Korçë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse, gjatë përgatitjes së strukturës pasardhëse, duhet të respektojë disa kërkesa specifike të vendosura me ligje të veçanta, që ndërveprojnë gjatë funksionimit të institucionit, të tilla si ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin që kërkon një raport të caktuar midis nëpunësit autorizues dhe atij zbatues, ligje që rregullojnë funksione të deleguara në pushtetin vendor nga administrata shtetërore, të cilat në dispozita të veçanta të tyre, përcaktojnë dhe mënyrën e organizimit të njësive të tilla, si seksionet e administrimit të mbrojtjes së tokës dhe Inspektoriatet.

3. Njësia përgjegjëse të vijojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe më tej, të konfirmojë pozicionin e tyre në raport me shërbimin civil, sipas rekomandimeve në raport, duke nxjerrë aktet përkatëse për punonjësit: ***** në pozicionin e punës “Drejtor Urbanistike”; ***** në pozicionin e punës “Përgjegjës në Drejtorinë e Urbanistikës”; ***** në pozicionin e punës “Specialiste në Drejtorinë e Projekteve Komunitare”; ***** në pozicionin e punës “Kryeinspektor në Inspektoriatin e Ndërtimit”; ***** “Inspektor i Lartë në Inspektoriatin e Ndërtimit” dhe ***** “Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Personelit”.
4. Njësia përgjegjëse të evidentojë në strukturën analitike dhe më tej të vijojë procesin e verifikimit të statusit të punësimit për punonjësit e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në mbështetje të kërkesave të nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke konfirmuar pozicionin e tyre në raport me shërbimin civil nëpërmjet akteve përkatëse.
5. Të rregullohet ligjshmëria e veprimeve të kryera gjatë procesit të implementimit të strukturës së re të institucionit, nëpërmjet revokimit të akteve administrative që kanë dalë deri në këtë moment dhe që kanë lidhje me pezullimin, emërimin dhe lirimën e nëpunësve të institucionit, që janë pjesë e shërbimit civil sipas rekomandimeve të dhëna në raportin e inspektimit, në lidhje me procesin e ristrukturimit. Të fillojë procesi nga e para dhe të ndiqet ky rend veprimesh:
 - a) Të ngrihet komisioni i ristrukturimit duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili është një mekanizëm që do të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar të të gjithë punonjësve, të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke krahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozita ligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast, duhet të jetë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse Udhëzimi nr.3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.
 - b) Komisioni i Ristrukturimit të paraqesë propozimet për lirimën nga shërbimi civil të atyre nëpunësve pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, kompetencë e tij që është parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - c) Njësia përgjegjëse pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, të përmbyllë procesin me vendim përfundimtar, për lirimën nga shërbimi civil për punonjësit të cilëve nuk iu ekziston më pozicioni i punës dhe nuk mund të sistemohen në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, apo riemërimin e punonjësve në pozicione të së njëjtës kategori. Në këtë moment duhet të tregohet kujdes që në rastin e uljes në detyrë të punonjësit të merret mendimi i tij me shkrim në lidhje me pranimin apo refuzimin e pozicionit të ofruar sipas përcaktimit të dispozitave ligjore.
6. Njësia përgjegjëse të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që përbën një proces kompleks dhe që është kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion, transferimi i tyre apo sistemimi në listën e pritjes.

7. Njësia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, nëpërmjet revokimit të aktit të emërimit, në rastet kur pozicionet e punës janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, pasi nuk janë respektuar procedurat për pranimin në shërbimin civil, për punonjësit: ***** punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, emëruar me Urdhrin nr.65, dt.16.10.2014; ***** punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, emëruar me Urdhrin nr.73, dt.07.11.2014; ***** punonjës i Këshillit të Qarkut Korçë, emëruar me Urdhrin nr.28, datë 29.04.2014; ***** punonjës i Këshillit të Qarkut Korçë, emëruar me Urdhrin nr.45, datë 26.06.2014 dhe ***** punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, emëruar me Urdhrin nr.58, datë 09.10.2014.

8. Për të gjitha pozicionet e punës që do të mbeten të lira, sipas pikës 7 të këtij vendimi, njësia përgjegjëse të vijojë procedurat e plotësimit të tyre sipas këtij rendi veprimesh:

Së pari: Komisioni i Ristrukturimit të bëjë krahasimin e kërkesave të pozicionit të punës, nëse përputhen me kriteret që plotësojnë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe që janë prekur nga procesi i ristrukturimit;

Së dyti: Në rast se asnjë nga këto punonjës nuk i plotëson kriteret për këto pozicione pune atëherë ato të shpallen pozicione pune të lira sipas dispozitave ligjore.

9. Të revokohen aktet e pezullimit nga detyra dhe aktet administrative të lirimit nga shërbimi civil të evidentuara nominalisht në raportin e inspektimit për punonjësit: ***** “specialiste në Drejtorinë e Financës”; ***** “specialiste në Drejtorinë e Financës”; ***** “specialiste në Drejtorinë e Investim Shërbimeve”; ***** “specialiste në Drejtorinë e Investim Shërbimeve”; ***** “specialist në Drejtorinë e Investim Shërbimeve”; ***** “Drejtor në Drejtorinë e Urbanistikës”; ***** “specialist në Drejtorinë e Urbanistikës”; ***** “specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”; ***** “Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”; ***** “Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”; ***** “Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës”. Të vijojnë procedurat për sistemimin e tyre pas ristrukturimit.

10. Të revokohen aktet administrative në lidhje me dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për punonjësen ***** Urdhri nr.45, datë 30.06.2014, i titullarit të institucionit dhe punonjësit ***** Urdhri nr.53, datë 06.10.2014 i titullarit të institucionit, sepse ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit, në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, pasi këto akte kanë dalë në kundërshtim me procedurat ligjore që duhen respektuar gjatë një procedimi disiplinor.

11. Njësia përgjegjëse të fillojë procesin e vlerësimit të punës për nëpunësit civil dhe të kujdeset që ky proces të realizohet në të gjitha fazat e tij, deri në finalizimin me një vlerësim përfundimtar të argumentuar, sipas rekomandimeve të raportit.

12. Njësia përgjegjëse të miratojë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, si detyrim që rrjedh nga përcaktimi i nenit 18 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimi nr.108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, të Këshillit të Ministrave.

13. Të plotësohet dosja e personelit për të gjitha rastet e konstatuara me mangësi në drejtim të administrimit të dokumentacionit, si dhe dokumentacioni që provon

procesin e konkurrimit, vërtetimi i gjendjes gjyqësore dhe gjendja shëndetësore. Pasi të hartohen dokumentat si përshkrimi i punës dhe vlerësimi i punës, ato duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit të nëpunësit.

- 14.** *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.*

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve në vendimin e mësipërm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14, të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Vendimin Nr.59, datë 17.06.2015.

Për këtë arsye, me Vendimin Nr.121, datë 16.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr.59, datë 17.06.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin Këshilli i Qarkut Korçë në datën 29.05.2017 dhe i kërkoi personit përgjegjës, nëpunësit ******, dosjet e personelit dhe dokumentacionin shkresor të dalë në zbatim të rekomandimeve të vendimit paralajmërues të Komisionerit.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në lidhje me rekomandimin (e materializuar në pikën 2 të vendimit) për të respektuar disa kërkesa specifike të vendosura me ligje të veçanta gjatë hartimit të strukturës së institucionit, si ligji për menaxhimin financiar (me qëllim që të sigurohet raporti nëpunës autorizues dhe nëpunës zbatues) apo ligjet që rregullojnë funksionet e deleguara në pushtetin vendor nga administrata shtetërore, situata ligjore paraqitet si më poshtë vijon:

Me Vendimin Nr.32, datë 25.03.2015, “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe ndërrmarrjeve të varësisë”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë, është miratuar struktura e institucionit, bazuar në ligjin nr.8652, dt.31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligjin nr.160/2014, datë 27.11.2014, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015” (si pasojë e të cilit, pati një shkurtrim të buxhetit të institucioneve vendore). Ky kuadër ligjor ka bërë detyrues ristrukturimin e institucionit si nga ana e strukturës organizative ashtu edhe në numrin e punonjësve (duke rezultuar në pakësim të numrit të tyre). Në këto kushte, organizimi i njësive organizative në përputhje me rekomandimin e Komisionerit ka qenë i kushtëzuar, e për rrjedhojë nuk ka mundur të zbatohet nga njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Korçë.

- Njësia përgjegjëse, bazuar në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në zbatim të pikës 3 të vendimit të Komisionerit, ka nxjerrë aktet e deklaramentit të statusit të punësimit për punonjësit e mëposhtëm:

- Aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.1128, datë 10.09.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës Drejtor Urbanistike, në Këshillin e Qarkut Korçë;
 - Aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.37, datë 12.05.2014, për punonjësin *****, në pozicionin e punës Përgjegjës në Drejtorinë e Urbanistikës, në Këshillin e Qarkut Korçë;
 - Aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.16, datë 12.05.2014, për punonjësen *****, në pozicionin e punës Specialiste në Drejtorinë e Projekteve Komunitare, në Këshillin e Qarkut Korçë;
 - Aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.1129, datë 10.09.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës Kryeinspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit, në Këshillin e Qarkut Korçë;
 - Aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.41, datë 22.05.2014, për punonjësin *****, në pozicionin e punës Inspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit, në Këshillin e Qarkut Korçë;
 - Sipas aktit administrativ nr.1127, datë 10.09.2015, punonjësit *****, i është refuzuar statusi i nëpunësit civil dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punësimit, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- Në zbatim të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse pasi ka bërë verifikimin e statusit të punësimit të punonjësve të Drejtorisë së Administrimit të Mbrojtjes së Tokës, në mbështetje të nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit për punonjësit e kësaj strukture si më poshtë:
- Aktin nr.24, datë 12.05.2014, për deklaramin e statusit të punësimit për punonjësen ***** në detyrën Drejtor i Administrimit të Mbrojtjes së Tokës.
 - Aktin nr.13, datë 12.05.2014, për deklaramin e statusit të punësimit për punonjësin ***** në detyrën Specialist në Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës (*dega Pogradec*).
 - Aktin nr.22, datë 12.05.2014, për deklaramin e statusit të punësimit për punonjësen ***** në detyrën Specialiste në Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës.
 - Aktin nr.14, datë 12.05.2014, për deklaramin e statusit të punësimit për punonjësen ***** në detyrën Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës (*dega Devoll*).
 - Aktin nr.23, datë 12.05.2014, për deklaramin e statusit të punësimit për punonjësen ***** në detyrën Specialiste në Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës.
 - Aktin nr.27, datë 12.05.2014, për deklaramin e statusit të punësimit për punonjësin ***** në detyrën Kryeinspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës.
- Njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, në zbatim të pikës 5 të vendimit paralajmërues, ka kryer revokimin e akteve administrative që kanë lidhje me pezullimin, emërimin dhe lirimin e nëpunësve të institucionit, që janë pjesë e shërbimit civil, sikundër do të trajtohet më konkretisht në vijim, gjatë analizës së zbatimit të pikës 9 të vendimit.

Për të rivendosur gjendjen e ligjshmërisë, në përputhje me ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nga ana e Njesisë përgjegjëse ka nisur nga e para procesi i ristrukturimit, sipas përcaktimeve ligjore si më poshtë:

Në zbatim të pikës 3 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me Urdhrin nr.91, datë 19.11.2015, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit, i cili ka shqyrtuar mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil, të cilëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punësimit në kundërshtim me ligjin dhe i ka propozuar njesisë përgjegjëse transferimin e çdo nëpunësi në një pozicion të lirë, në të cilin plotëson kërkesat specifike. Vendimet përfundimare në bazë të propozimeve të mësipërme i ka marrë njësia përgjegjëse për të gjithë nëpunësit, mbështetur në Vendimin nr.32, dt.23.03.2015, për miratimin e strukturës së Këshillit të Qarkut Korçë, si më poshtë:

- Vendimi nr.1, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Financës”.
- Vendimi nr.2, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve”.
- Vendimi nr.3, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve”.
- Vendimi nr.4, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialiste për Koordinim, Hartim dhe Zbatim Projektesh në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve”.
- Vendimi nr.5, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist për Urbanistikën në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve”.
- Vendimi nr.6, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialiste për Turizmin dhe Kulturën në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve”.
- Vendimi nr.7, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor në Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve”.
- Vendimi nr.8, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”.
- Vendimi nr.9, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”.
- Vendimi nr.10, datë 23.11.2015, për transferimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës”.

Punonjësit e mësipërm janë riemëruar nga njësia përgjegjëse pas procesit të ristrukturimit.

Për punonjësit që do të përmenden më poshtë, nga ana e Komisionit të Ristrukturimit është propozuar përfundimi i marrëdhënies së punësimit, për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës. Njësia Përgjegjëse ka nxjerrë vendimin përfundimor dhe në zbatim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, punonjësit kanë përfituar të drejtën e dëmshpërblimit financiar, si më poshtë:

- Vendimi nr.11, datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësën ***** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës;

- Vendimi nr.12, datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësin ***** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Urbanistikës;
 - Vendimi nr.13, datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësën ***** me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Financës;
 - Vendimi nr.14, datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësën ***** me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Financës;
 - Vendimi nr.15, datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësën ***** me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Investim-Shërbimeve;
 - Vendimi nr.16, datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësin ***** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Investim-Shërbimeve;
 - Vendimi nr.17 datë 23.11.2015, “Për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil”, për punonjësin ***** me detyrë Inspektor në IMT.
- Bazuar në nenin 50 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, VKM nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lrimin nga shërbimi civil” dhe në zbatim të pikës 6 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse, përpara nisjes së procesit të ristrukturimit, ka miratuar kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicioneve të punës të krijuara, në mënyrë që risistemimi i punonjësve apo transferimi i tyre dhe regjistrimi në listën e pritjes të bëhet duke patur parasysh kërkesat për pozicionet e punës.
- Në lidhje me rekomandimin e Komisionerit të materializuar në pikën 7 të vendimit, për përfundimin e marrëdhënies së punësimit nëpërmjet revokimit të akteve të emërimit, në rastet kur pozicionet e punës janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, duke mosrespektuar procedurat për pranimin në shërbimin civil, njësia përgjegjëse ka bërë revokimin e këtyre akteve, për punonjësit si më poshtë:
- Urdhri nr.70, datë 04.09.2015, “Për revokimin e Urdhrit nr.28, datë 24.09.2014, të punonjësit *****”;
 - Urdhri nr.72, datë 04.09.2015, “Për revokimin e Urdhrit nr.65, datë 16.10.2014, të punonjësën *****”;
 - Urdhri nr.71, datë 04.09.2015, “Për revokimin e Urdhrit nr.45, datë 24.09.2014, të punonjësit *****”;
 - Urdhri nr.73, datë 04.09.2015, “Për revokimin e Urdhrit nr.58, datë 09.10.2014, të punonjësën *****”;
 - Urdhri nr.74, datë 04.09.2015, “Për revokimin e Urdhrit nr.73, datë 07.11.2014, të punonjësën *****”.
- Në zbatim të pikës 8 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse, në bazë propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, i cili ka bërë krahasimin e kërkesave të veçanta për pozicionet e krijuara pas procesit të ristrukturimit të institucionit, përfshirë dhe ato të përmendura në pikën 7 të vendimit, të cilat kanë rezultuar të lira, pas revokimit të akteve të emërimit të punonjësve të cituar më lart, ka bërë risistemimin, ose ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit të punonjësve, për shkak

të plotësimit ose jo të kërkesave specifike (sqsuar gjatë analizës së zbatimit të pikës 5 të vendimit të Komisionerit).

- Njësia Përgjegjëse, në zbatim të pikës 9 të vendimit të Komisionerit, me Urdhrin nr.43, datë 03.06.2015 dhe Urdhrin 45, datë 09.06.2015, ka revokuar Urdhrin nr.36, datë 18.05.2015, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të këshillit të qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës” dhe Urdhrin nr.12, datë 10.02.2015, për pezullim nga detyra, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë, për punonjësit: *****; *****; *****; *****; *****; *****; *****; *****; ***** dhe ***** (gjatë analizës së zbatimit të pikës 5 të vendimit është sqsuar dhe situata aktuale e këtyre punonjësve, pas procesit të ristrukturimit).
- Në lidhje me rekomandimin e Komisionerit për revokimin e akteve administrative për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” në ngarkim të punonjësve ***** dhe *****, si akte absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, ligj që ka qenë në fuqi në atë periudhë, rezultoi se çështjet i kishin kaluar juridiksionit gjyqësor. Për këtë arsye, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, kjo çështje nuk mund të ndiqet më tej nga juridiksioni administrativ.
- Gjatë verifikimit në subjekt, rezultoi se, në zbatim të pikës 11 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Korçë kishte bërë vlerësimet e rezultateve individuale në punë në përputhje me përcaktimet e nenit 62 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, duke e finalizuar këtë proces me një vlerësim përfundimtar të argumentuar, ashtu sikundër është rekomanduar edhe në raportin përfundimtar të inspektimit nga Komisioneri.
- Përsa i përket pikës 12 të vendimit të Komisionerit, në përfundim të verifikimit rezultoi se njësia përgjegjëse nuk e kishte hartuar planin e nevojave për vitin 2016, mbështetur në VKM nr.108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, për shkak se Këshilli i Qarkut Korçë kishte kaluar procesin e ristrukturimit, bazuar në ligjin nr.160/2014, datë 27.11.2014, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015” (ishin pakësuar në mënyrë të ndjeshme pozicionet e punës) dhe nuk rezultoi pozicione të lira.
- Në zbatim të pikës 13 të vendimit të Komisionerit, dosjet e personelit ishin plotësuar me dokumentacionin e munguar (raportet mjekësore dhe dëshmitë e penalitetit). Dosjet ishin plotësuar sipas përcaktimeve të pikës 6 të Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr.59, datë 17.06.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Këshillin e Qarkut Korçë”, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Këshillit të Qarkut Korçë janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Këshillit të Qarkut Korçë, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 59, datë 17.06.2015, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Këshillin e Qarkut Korçë*”.
2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Këshillit të Qarkut Korçë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA